



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS


KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Instituti Mollëtimor Nr. Prot. 979/2, Data 14/10/24,
Shkurtimi i lëndës: Dëgim përfaqje

Për trajtim nga:	<u>Projekt</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	

Afat: Normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/për dijeni
Tjetër ditë

Data 21.10.24, Nr. Prot. 1062/6

Nënshkrimi: (TITULLARI) 

Marre në dorëzim: 22.10.24

Nënshkrimi: 

Kalon për trajtim (struktura): J. Horaniq J. Kufi 22.10.24

Me porosinë: _____

Marre në dorëzim: _____

Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marre në dorëzim: _____

Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim Specialistit: _____

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____

Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar më: _____

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____


Eprori në shkallë hierarkike





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Nr. 979/prot
12



Date 14/10/2024

Lënda: Dërgim përgjigje për rishikimin e Oponencës Teknike të akt ekspertizës së thelluar

BASHKISË DURRËS

Lagjja Nr.1 , Sheshi "Liria", Durrës

Në bazë të kërkesës suaj me Nr.1062/4 prot, datw. 25.06.2024, protokolluar me tonën me Nr.979 Prot, datë. 27.06.2024, "Kërkesë për rishikimin të akt ekspertizës së thelluar", Bazuar në Nenin 34, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", po ju dërgojmë në 2 kopje, oponencën teknike të objektit: "Pallati Nr.1047" (ARVI) , Rruga "Taulantia", (27498), Bashkia Durrës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Artan SHKRELI



OPONENCË TEKNIKE
MBI RISHIKIMIN E AKT EKSPERTIZËS SË THELLUAR TË OBJEKTIT:
“PALLATI NR.1047” (ARVI) , RRUGA “TAULANTIA”, (27498),
BASHKIA DURRËS

POROSITËS : BASHKIA DURRËS

PROJEKTUES : SHOQËRIA: “ARKONSTUDIO ” SH.P.K.

GRUPI I PROJEKTIMIT

- Ing. Dhimitër PAPA

Nr. Liç. K.1510/2

Bëhet kjo oponence teknike mbi projektin e ndryshuar të akt ekspertizën e thelluar të objektit: “PALLATI NR.1047” (ARVI) , RRUGA “TAULANTIA”, (27498), BASHKIA DURRËS, Bazuar në **Nenin 34**, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Materialet e paraqitura për hartimin e oponencës teknike janë:

- Kërkesa për kryerjen e Oponencës Teknike e shoqërisë Bashkisë Durrës me Nr. 1062/4 Prot, date. 25.06.2024, protokolluar me tonen me Nr. Prot.979 , Datë 27.06.2024.
- Marrëveshja ndërmjet Institutit të Ndërtimit dhe Bashkisë Durrës me nr.1062/5 prot, date .03.07.2024 dhe me Nr. 979/1 Prot,date.28.06.2024 te IN-së, ku tarifa e rishikimit të oponencës teknike për këtë objekt është **50,000** (pesëdhjetë mijë) lekë me TVSH .
- Akt ekspertiza e thelluar per gjendjen ekzistuese dhe te perforcuar
- Projekti konstruktiv i perforcimit
- Preventivi i punimeve
- Relacion

1. TË PERGJITHSHME

Sipas Akt ekspertizes se rishikar Objekti “PALLATI ARVI, RRUGA TAULANTIA” perfaqeson nje objekt me 9 kate mbi toke + 1 kate podrum, i rregullt ne vertikalisht dhe i pa rregullt ne plan. Objekti ka siperfaqe te katit rreth 840 m². Lartesia e podrumit eshte rreth 2.80 m, lartesia e katit perdhe eshte rreth 4.14 dhe lartesia e katit tip eshte rreth 3.06 m. Destinacioni kryesor eshte ai i banimit dhe i sherbimit dhe ka nje siperfaqe te pergjithshme rreth **8200 m²**.

Struktura e objektit eshte konceptuar dhe realizuar me konstruksion mbajtes me rama beton arme (EC8 Frame System), ku ngarkesa sizmike perballohet kryesisht nga kolonat dhe traret. Objekti i jep



prioritet të dy drejtimeve perpendikulare për garantimin e zhvendosjeve të lejuara nga veprimet e ngarkesave të jashme, kryesisht atyre sizmike. Strukturat horizontale përfaqësohen nga elemente beton arme, soleta pjesërisht monolite dhe pjesërisht me traveta. Në tërësi, struktura e objektit përfaqësohet nga një sistem i pastër konstruktiv, ku themeli është realizuar me pllake beton arme, elementet vertikale me kolona b/a dhe elementet horizontal nga trare beton arme, soletat monolite dhe me traveta.

Themeli është realizuar me pllake beton arme me trashësi rreth 100-120 cm.

Kolonat janë realizuar b/a me seksione: $b \times h = 30 \times 60$ cm, $b \times h = 70 \times 40$ cm dhe me seksion rrethor me $D = 60$ cm, etj.

Muratura ndarese është realizuar me tulla të kuqe me bira (vetembajtëse) me gjëresë 12, 20 dhe 25 cm.

Traret janë kryesisht me prerje tërthore drejtkëndëshe me permasa $b \times h = 30 \times 50$ cm, $b \times h = 40 \times 60$ cm dhe petashuqe me permasa kryesisht $b \times h = 70 \times 25$ cm, $b \times h = 80 \times 25$ cm.

Soletat janë realizuar prej beton arme pjesërisht monolite dhe pjesërisht me traveta. Soletat me traveta kanë trashësi 25 cm dhe janë të mbështetura në një ose dy drejtime në varësi të hapësirës që ato mbulojnë.

Celiku i përdorur në elementet beton arme është çelik i tipit S500, betoni i përdorur i përket klasës C20/25, për realizimin e elementeve të themeleve dhe të elementeve të tjera të mbistruktura.

Sipas studimeve perkatese ka rezultuar se Sheshi i ndërtimit në studim klasifikohet si truall i kategorisë së II-të sipas KTP-N.2-89, Truall i Klases B sipas EC-8, (EC-8, 2004).

Nga studimi gjeologjik në sheshin e ndërtimit rezultoi se në këto shesh takohen depozitimet e Kuaternarit (Q4 dt+kt) që përfaqësohen nga suargjila, argjila lymore dhe surera si dhe depozitimet Neogjenike që përbehen nga argjilite, ranore, konglomerate.

Niveli i ujit nentokesor është (-2.00) m nga sipërfaqja e tokës, por në kohë me lageshti ngrihet deri në thellesinë (-0.50) m. Janë ujra të kripura, janë agresive kundër hekurit dhe betonit, prandaj rekomandojmë të merren masa kundër veprimit negativ të ujit nentokesor. Prezenca e depozitimeve të dobëta në këto shesh ndërtimi si edhe lekundjet e termetit, kanë bërë që të lëngëzohen pjesërisht disa nga shtresat nën themele të cilat kanë sjellë dhe dëmtimin e pjesëshëm të godinës.

2. RAPORTI I RI I VLERËSIMIT STRUKTURAL (ANALIZA E THELLUAR E NDRYSHUAR)

Akt ekspertizë e thelluar e rishikuar si edhe projekti i nderhyrjeve për përfortimin dhe restaurimin e objektit ekzistues, me qëllim rritjen në nivelin e sigurisë së normave të sotme Evropiane të Forcës (EC), është hartuar nga shoqëria "ARKON STUDIO" sh.p.k. me inxhinier konstruktor **Dhimitër Papa**. Në këtë akt ekspertizë jepen përshkrimi i struktura në gjendjen ekzistuese, të dhëna mbi materialet e ndërtimit, dokumentimi gjeometrik i struktura ekzistuese, niveli i njohjes së objektit, përshkrimi i dëmtimeve nga termeti, katalogimi i tyre, të dhëna gjeologjike dhe sizmike të sheshit të ndërtimit, matjet topografike të sheshit të ndërtimit si dhe kontrolli i vertikalishtetit të objektit. Jepen testet dhe provat laboratorike të kryera në objekt, për të përcaktuar karakteristikave fiziko mekanike të materialeve përberëse ndërtimore dhe rezistencat e tyre, sasise dhe mënyres së armimit. Është realizuar analiza lineare e modelit ekzistues si dhe e modelit të forcuar, Pasi është bërë analizimi i rezultateve të dalës është konkluduar që objekti nuk i kap nivelet e performancës së kërkuar. Nga ana e



projektuesve është propozuar që të realizohet perforcimi i objektit duke shtuar mure b/a të cilët arrijnë të kontrollojnë drifitet e struktura dhe kemishimine disa kolonave. Me tej projektuesi ka realizuar projektin e zbatimit të nderhyrjeve të propozuar dhe në fund fare ka hartuar preventivin e cmimeve dhe ka nxjerrë vlerën që duhet për rikonstruksionin e objektit.

Në opionencën e mëparshme të kryer nga Instituti i Ndërtimit për këtë objekt ka rezultuar që ky objekt duhet të përforcohet dhe të rikonstruktohet me një vlerë të punimeve të rikonstruksionit prej **114,079,767 lekë pa tvsh**. Vlerësimi sipas sipërfaqes ekzistuese në përqindje dhe cmimeve për m² të Entit të Banesave ka rezultuar me e vogël se 70%.

Vlera e re e punimeve të rikonstruksionit është **74,079,767 lekë pa tvsh**.

Sipas materialit shpjegues (relacionit teknik) që shoqëron materialin autorët theksojnë se: Rishikimi i projekt-preventivit për pallatin nr.1047, rruga Taulantia Gis.27498, konsiston në rimodelimin e objektit sipas gjendjes aktuale duke sjellë uljen e punimeve të përforcimit dhe të muraturës.

3. PROJEKTI I PËRFORCIMIT

Projekti i përforcimit i mëparshëm jep planimetritë e kateve në gjendjen ekzistuese, planimetritë me perforcimet që do të kryhen për të gjitha katet nga kati podrum deri në katin e pestë, detajet e perforcimit të kolonave me mure, detajet e kemishimit të kolonave, perforcimi i mureve të tullës me breza dhe kolona antisizmike, detaji i lidhjes së mureve të tullës me kolonat.

Projekti i ri, jep planimetritë në gjendjen ekzistuese, planimetritë ku tregohen perforcimet që do të realizohen, Shtimi i mureve beton arme në kafazin e shkalleve në katet e para dhe katet podrum, perforcimi i kolonave me mure b/a, kemishimi i kolonave, të percaktuara në projektin e perforcimit, si dhe detajet e mureve të rinje b/a, detajet e kemishimit të kolonave.

Pra projekti i ri ka paraqitur ndryshimet sipas analizës së re të thelluar. Ky projekt konsiston në shtimin e mureve beton arme, kemishimi i kolonave, të percaktuara në projektin e perforcimit.

4. PREVENTIVI I RISHIKUAR

Preventivi i ripunuar jepet në 2 faqe format A4, hartuar nga projektuesi shoqëria "ARKONSTUDIO" me Ing. Dhimiter Papa.

Vlera e re e punimeve të përforcimit është **74,079,767 leke pa TVSH**, e cila duke e krahasuar me vlerën totale të ndërtimit të objektit nga e para $8200 \text{ m}^2 * 32,105 \text{ lekë/m}^2 = 263.261,000 \text{ lekë me tvsh}$ ose **(219,384,166 leke pa tvsh)**, duke iu referuar kostove ndërtimore në treg për një sipërfaqe të njëjtë është 34 % më e vogël se 70%, (34 % < 70%).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Oponenca për këtë fazë të ndryshimeve të projektit nuk do të shprehet në lidhje me cmimet në preventivin e punimeve, pasi ky preventiv është hartuar me cmime sipas manualit të vjetër. Përgjegjësia për volumet e punimeve të preventivit është e projektuesit, që kanë miratuar të gjitha ndryshimet në volumet e punimeve.

PËRFUNDIM:

Si përfundim mund të themi se nga shqyrtimi i materialit të objektit: "PALLATI NR.1047" (ARVI) , RRUGA "TAULANTIA", (27498), BASHKIA DURRËS, Projekti i zbatimit ka paraqitur ndryshimet e propozuara në analizen e thelluar dhe preventivin e punimeve. Projekti i perforcimit gjatë zbatimit të punimeve, duhet të plotësohet me të gjitha detajet e elementeve strukturor.



Punoi:

Ing. Hamza Kazia

DREJTORE DREJTORIE
Ing. Valbona PONDE

